



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE SANKSIONEVE

Data: 10.5.2024

Nr: 9

Ora: 11:45

VENDIM

PËR

PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 5, DATË 8.5.2024 TË DEPOZITUAR NGA SUBJEKTI "PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË"

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 10.5.2024, me pjesëmarrjen e:

Elvis	ÇEFA	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Illirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: Partia Socialiste e Shqipërisë

OBJEKT: Kundërshtim i vendimit nr. 38, datë 09.04.2024 "Për miratimin e raportit mbi gjetjet nga auditimi i raporteve financiare të partive politike për të ardhurat dhe shpenzimet për vitin kalendarik 2022", të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

BAZË LIGJORE: Nenet 21 pika 1 shkronja "b", 123/1, 124, 129 dhe 130 të Kodit Zgjedhor.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

Data: 10.5.2024 Nr: 9
Ora: 11:45



"Për pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 5, datë 8.5.2024 të depozituar nga subjekti 'Partia Socialiste e Shqipërisë'"

VËREN:

Subjekti “Partia Socialiste e Shqipërisë”, ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 05 regj., datë 8.5.2024.

Në mbledhjen e datës 10.5.2024, pas relatimit të z. Elvis Çefa u konstatua se kërkesa ankimore nr. 5, i plotëson elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130, të Kodit Zgjedhor dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

Për arsye se subjektet kundrejt të cilëve është vendosur sanksioni administrativ me gjobë, të cilët kanë interes të ligjshëm për të bërë ankim ndaj vendimit nr. 38/2024 të KSHZ, kanë marrë dijen me këtë vendimin në datën 26.4.2024, për të respektuar afatin 30 ditor për ndonjë ankim tjetër të mundshëm, KAS do të caktojë datën 4.6.2024, ora 11:00 për zhvillimin e seancës për shyrtrimin e themelit të kësaj kërkesë ankimore.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “a” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

V E N D O S I:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 5, datë 8.5.2024, të paraqitur nga subjekti “Partia Socialiste e Shqipërisë”.
2. Shqyrtimi i kërkesës ankimore do të zhvillohet më datë 12.02.2024, ora 12:00.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe përfundon me çeljen e seancës së shqyrtimit në themel, sipas shkronjës “b”, të nenit 68 të Kodit të Procedurave Administrative.

Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk mund të bëhet ankim.

Elvis	Çefa	-	Relator
Elvin	Lako	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar